

Design Thinking

I përfaqshuar nga kompani inovative si Google apo Apple, Dizenjimi i të menduarit/ Design Thinking është një metodologji e bazuar në mënyrën sesi mendojnë dizenjuesit, mënyrë e cila i lejon ata të testojnë shpejt projekte, produkte dhe shërbime brenda organizatave.

Përfitimet e dizenjimit të të menduarit për një kompani

Si një mjet në shërbim të inovacionit/ risive, dizenjimi i të menduarit është një metodologji e cila bën të mundur kthimin e ideve dhe projekteve në veprime të vërteta, duke e vënë përdoruesin në qendër të nismës.

Përmes dizenjimit të të menduarit, punonjësit vlerësojnë nevojat emocionale të klientëve të tyre të brendshëm/ jashtëm dhe çfarë ndikimi mund të kenë ata në përvojën e tyre.

I organizuar në formën e një pune në grup, pjesëmarrësit kalojnë nëpër një proces mendimplotë se si t'i përkthejnë idetë në realitet dhe si t'i testojnë ato me përdoruesit.

Më tepër se një metodologji pune, dizenjimi i të menduarit është një mendësi për t'u integruar në kompani. Përdorimi i dizenjimit të të menduarit në një projekt do të përshpejtojë kurbën e të mësuarit të ekipeve tuaja dhe zvogëlojë rreziqet e lidhura me nisjen e projektit.

Qasja me dizenjim të të menduarit mund të jetë një mënyrë shumë e mirë për të nisur një proces të menaxhimit të ndryshimeve apo të nisë projekte fleksibël dhe inovative.

Metodologjia

Sesionet e trajnimit janë dizenjuar të jenë interaktive. Eksperienca na ka treguar se pjesëmarrësit nxënë më shumë në aktivitetet në të cilat përfshihen aktivisht. Në një kohë të shkurtër në njëkohësisht maksimizojmë impaktin e mësimin si edhe përfshijmë personalisht në aktivitete çdo pjesëmarrës të grupit.

Target Grupi

Dizenjimi i të menduarit mund të aplikohet në të gjithë tipet e kompanive dhe organizatave: Të gjithë menaxherët dhe punonjësit të cilët dëshirojnë të drejtojnë dhe menaxhojnë projekte risi mund t'a përdorin këtë metodologji.

Kohëzgjatja:

2 ditë (09:00 - 17:00)

Tarifë pjesëmarrjeje: Përfshirë në çmim:

Për t'u përditësuar
2 pushime kafe + dreka